VENDIM
Nr. 171, datë 3.8.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT TË TË GJITHA OST-ve TË EVROPËS KONTINENTALE DHE NORDIKE PËR HIPOTEZAT DHE NJË METODOLOGJI TË ANALIZËS SË KOSTO-PËRFITIMIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 156(11) TË RREGULLORES SË KOMISIONIT BASHKIMIT EVROPIAN (BE) 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017, QË PËRCAKTON NJË UDHËZUES MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike"; i ndryshuar, nenit 167 të "Kodit të Transmetimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, nenit 156(11) të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485, të datës 2.8.2017, neneve 19 dhe 26, të "*Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s*", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me propozimin e të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një metodologji të analizës së kosto-përfitimit në përputhje me nenin 156(11) të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485, të datës 2.8.2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- OST sh.a., me shkresën nr. 5020 prot., datë 9.7.2018, protokolluar në ERE, me nr. 500 prot., datë 10.7.2018, ka kërkuar miratimin e "Propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike, për hipotezat dhe një metodologji të analizës kosto-përfitim".

- Kjo kërkesë vjen me qëllim zbatimin e detyrimeve për të gjitha vendet pjesëmarrëse/ anëtare në ENTSO-E.

- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. është anëtar me të drejta të plota në ENTSO-E.

- Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemit të Transmetimit të Evropës Kontinentale dhe zonave sinkrone nordike, në lidhje me përcaktimin e hipotezave dhe një metodologjie për një analizë të kosto-përfitimit që do të kryhet, me qëllim që të vlerësohet periudha kohore e kërkuar për rezervat e mbajtjes së frekuencës (FCR), njësitë ose grupet ofruese me Rezervuare të Kufizuar të Energjisë për të mbetur të disponueshëm gjatë gjendjes së alarmit, në përputhje me nenin 156(11) të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485, të datës 2.8.2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

- Metodologjia e analizës së kosto-përfitim (CBA) për propozimin e rezervës së mbajtjes të frekuencës (FCR), merr në konsideratë parimet dhe qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në Rregulloren e udhëzimit për Operimin e Sistemit, si dhe Rregulloren e Komunitetit të Energjisë (EC) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13.7.2009, mbi kushtet e aksesit në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike.

- Metodologjia e analizës së kosto-përfitim për propozimin e rezervës së mbajtjes të frekuencës (FCR), kontribuon në ndjekjen e objektivave të përgjithshme të Rregullores së udhëzuesit për Operimin e Sistemit për ruajtjen e sigurisë operacionale duke përcaktuar periudhën e duhur kohore për aktivizimin e plotë të rezervave të mbajtjes së frekuencës (FCR) në gjendjen e alarmit duke marrë parasysh kostot dhe përfitimet e periudhës kohore të përcaktuar, në të mirën e të gjithë pjesëmarrësve të tregut dhe konsumatoreve fundorë të energjisë elektrike.

- Kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, të cilat e përcjellin për miratim tek autoritet rregullatore respektive.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një Metodologji të analizës së kosto-përfitimit, në përputhje me nenin 156(11) të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2017/1485, të datës 2.8.2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

DOKUMENTI SHPJEGUES

MBI PROPOZIMIN PËR SUPOZIMET DHE METODOLOGJINË PËR NJË ANALIZË KOSTO - PËRFITIM (CBA) NË PËRPUTHJE ME KËRKESAT E PËRMBAJTURA NË NENIN 156(11) TË RREGULLORES SË KOMISIONIT (BE) 2017/1485, TË DATËS 2 GUSHT 2017 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (RREGULLORJA E UDHËZIMIT PËR OPERIMIN E SISTEMIT - SOGR)

28 shkurt 2018

Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave
2. Hyrja
3. Përshkrimi i FCR-së
4. Supozimi kryesor i metodologjisë
5. Metodologjia

1. Lista e shkurtesave

ACE	Gabimi i Kontrollit të Zonës
CE	Evropa Kontinentale
LER	Njësitë ose grupet siguruese të FCR-së me burime të kufizuara të energjisë
FCR	Rezerva e Mbajtjes së Frekuencës
FCP	Procesi i Mbajtjes së Frekuencës
FRR	Rezervat e Restaurimit të Frekuencës
FRP	Procesi i Restaurimit të Frekuencës
FSM	Mënyra në ndjeshmëri të frekuencës
Non-LER	Njësitë ose grupet siguruese të FCR-së me burime të pakufizuara të energjisë
NP RES	Burimet e energjisë së rinovueshme të paprogramueshme
RES	Burimet e Energjisë së Rinovueshme
SO GL	Udhëzuesi mbi Operimin e Sistemit
T_{min} LER	Sapo të nxitet gjendja e alarmit dhe gjatë gjendjes së alarmit, është koha për të cilën çdo sigurues i FCR-së do të sigurojë që njësitë e tij siguruese të FCR-së nga rezervuarë të kufizuar të energjisë janë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR-në në mënyrë të vazhdueshme.

2. Hyrja

2.1 Konteksti dhe qëllimi i raportit

Udhëzuesi për operimin e sistemit (SO GL) i hartuar nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit për Energji Elektrike (ENTSO-E) nën drejtimin e Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER) u miratua në Komitet në maj 2016, dhe në gusht 2017 nga Komisioni Evropian.

Neni 156(11) i SO GL kërkon përcaktimin e një metodologjie për një analizë të kosto-përfitimit (CBA) për vlerësimin e periudhës kohore të kërkuar për njësitë ose grupet me Rezervuarë të Kufizuar të Energjisë (LER) që ofrojnë FCR-në në Evropën Kontinentale (CE) dhe zonat sinkrone nordike.

Brenda 12 muajve pas miratimit të supozimeve dhe metodologjisë nga të gjithë autoritetet rregullatore të rajonit në fjalë, OST-të e Evropës Qendrore dhe zonave sinkrone nordike do të paraqesin rezultatet e analizës së tyre të kosto-përfitimit, duke sugjeruar një periudhë kohore nga 15 deri në 30 minuta, që të

jetë e disponueshme gjatë gjendjes së alarmit të sistemit.

Objektivi kryesor i metodologjisë së CBA-së i përshkruar në këtë dokument është zgjedhja e zgjidhjes që minimizon kostot e FCR-së pa rrezikuar sigurinë operacionale. Periudha e lartpërmendur që do të identifikohet pas zbatimit të kësaj metodologjie do të përdoret si një kërkesë për Ofruesit e Shërbimit të Balancimit që përdorin burime me rezervuarë të kufizuar të energjisë për ofrimin e FCR-së. Ofruesit e Shërbimit të Balancimit do të duhet të sigurohen së në çdo moment gjatë gjendjes normale, burimet e LER-it kanë gjithmonë një kapacitet të energjisë që do t'u lejojë atyre të mbeten të disponueshëm për kohën minimale të përcaktuar nga studimi gjatë gjendjes së Alarmit, duke përdorur një strategji të menaxhimit të energjisë.

Sipas nenit 18 (2c) të SO GL sistemi i transmetimit do të konsiderohet në gjendje Alarmi kur:

- Vlera absolute e devijimit të frekuencës së sistemit në gjendje të qëndrueshme nuk është më e madhe se devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme; dhe
- Vlera absolute e devijimit të frekuencës së sistemit në gjendje të qëndrueshme ka tejkaluar vazhdimisht 50% të devijimit maksimal të frekuencës së gjendjes së qëndrueshme, për një periudhë kohore më të gjatë së koha e nxitjes (ngacmimit) së gjendjes së alarmit ose diapazonit standard të frekuencës për një periudhë kohe më të gjatë së koha për rivendosjen e frekuencës.

Përcaktimi i periudhës së kohës minimale nga zbatimi i kësaj metodologjisë të CBA-së është një kërkesë e cila duhet të përmbushet në gjendjen e alarmit, ndërsa ofruesi i FCR-së duhet të sigurojë që FCR-ja nga njësitë ose grupet me rezervuarë të kufizuar të energjisë siguruese të FCR-së, janë në mënyrë të vazhdueshmem të disponueshme gjatë gjendjes normale (neni 156 (9) i rregullores SO GL).

Rezultatet e këtij studimi do të përdoren nga OST-të për të përcaktuar rregullat e parakualifikimit për LER-të. Në fakt, pas këtij studimi, secili OST duhet të llogarisë kapacitetin total të energjisë minimale që një LER duhet të ketë për t'u parakualifikuar për sigurimin e FCR-së.

Kërkesat për operimin e burimeve të LER të lartpërmendura, kur frekuenca është brenda intervalit të frekuencës standarde janë jashtë fushëveprimit të kësaj metodologjie.

Ky dokument siguron përcaktimin e metodologjisë duke përmbushur kërkesat që ka neni 156(11) i Rregullores së udhëzuesit për operimin e sistemit, i cili përbën bazën për zbatimin e mëvonshëm të CBA-së.

2.2 Organizimi i raportit

Seksioni 3 ofron një pasqyrë të kërkesave të FCR-së dhe Rregullores së BE-së për ofrimin e tij. Seksioni 4 përshkruan supozimet kryesore të marra në konsideratë për hartimin e metodologjisë në lidhje me afatet kohore të përfshira në modelin e simulimit.

Seksioni 5 ilustron metodologjinë duke siguruar:

- Bllok-skemën e procedurës (skemat hyrëse-dalëse);
- Metodologjinë për llogaritjen e disbalancave për t'u balancuar nga procesi i mbajtjes së frekuencës, duke filluar nga të dhënat historike të frekuencës dhe propabilitetin e ndërprerjeve të elementeve të rrjetit.
- Metodën probabilistike për vlerësimin e sigurisë operacionale dhe qëndrueshmërisë së sistemit në lidhje me skenarë të ndryshëm, me një periudhë kohe minimale të përcaktuar;
- Hipotezat kryesore dhe përshkrimet e vlerësimit të kostos;
- Përshkrimin e skenarëve të miratuar për të paraqitur zhvillimet e ardhshme potenciale të sistemit energjetik dhe teknologjitë e gjenerimit;
- Përshkrimin e kritereve për vlerësimin e periudhës kohore të nevojshme për LER-in që të mbetet i disponueshëm gjatë gjendjes së alarmit duke përfshirë analizat e rrezikut të qëndrueshmërisë gjatë ngjarjeve më të rëndësishme të frekuencave reale.

3. Përshkrimi i FCR-së

Rezerva e mbajtjes së frekuencës (FCR) në tregun e balancimit të brendshëm të energjisë në Bashkimin Evropian i referohet rezervave operative të nevojshme për mbajtjen e vazhdueshme të devijimeve nga vlera nominale të frekuencës, në mënyrë që të ruajnë vazhdimisht balancën e fuqisë në të gjithë sistemin sinkron të interkonektuar.

Një përkufizim i FCR-së është dhënë në nenin 3 (6) të SO GL ku FCR-ja përfaqëson "rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një disbalance".

Aktivizimi i kësaj rezerve rezulton në një restaurim të balancës së fuqisë, për një frekuencë që devijon nga vlera nominale. FCR-ja në një zonë të sinkronizuar është me rëndësi të veçantë për besueshmërinë operacionale të zonës, pasi ajo lejon stabilizimin e frekuencës së sistemit në afatin kohor të sekondave, në një vlerë stacionare të pranueshme në rast të një shqetësimi ose një incidenti. FCR-ja varet nga rezerva

e vënë në dispozicion të sistemit nga njësitë e sigurimit të FCR-së (p.sh. njësitë gjeneruese, burimet e kontrollueshme të ngarkesës dhe lidhjet HVDC). FCR-ja e siguruar nga njësitë gjeneruese është një funksion i shpejtë, automatik dhe i decentralizuar që rregullon prodhimin e fuqisë së njësive gjeneruese si pasojë e devijimit të frekuencës së sistemit. FCR-ja aktivizohet lokalisht dhe automatikisht në vendin e njësisë siguruese të FCR-së, pavarësisht nga aktivizimi i llojeve të tjera të rezervave.

Më shumë detaje mbi një temë të tillë mund të gjenden më tepër në Bashkimin Evropian SO GL. Veçanërisht, udhëzimet kërkojnë në nenin 156, së paku për zonat sinkrone për Evropën Kontinentale dhe Nordike, që:

- Njësia e sigurimit të FCR-së duhet të garantojë disponueshmërinë e vazhdueshme të FCR-së së saj gjatë periudhës së kohës në të cilën është e detyruar të ofrojë FCR (me përjashtim të një ndërprerjeje të detyruar);
- Një njësi e sigurimit të FCR-së me një rezervuar të energjisë që nuk kufizon aftësinë e tij për të siguruar FCR-në do të aktivizojë FCR-në e tij për aq kohë sa devijimi i frekuencës vazhdon;
- Një njësi e sigurimit të FCR-së me një rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë e tij për të ofruar FCR-së duhet të aktivizojë FCR-në e saj për aq kohë sa devijimi i frekuencës vazhdon, përveç nëse rezervari i tij energjetik është shterur në drejtimin pozitiv ose negativ me sqarimet e mëposhtme:
- gjatë gjendjes normale, FCR-ja nga njësitë siguruese me rezervuare të kufizuar të energjisë të FCR-së, duhet të jetë e disponueshme në mënyrë të vazhdueshme.
- sapo të jetë nxitur gjendja e alarmit dhe si dhe gjatë gjendjes së alarmit, FCR-ja nga njësitë siguruese me rezervuarë të kufizuar të energjisë të FCR-së, do të aktivizohen plotësisht në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë kohe që do të përcaktohet në përputhje me CBA-në. Kur nuk është përcaktuar asnjë periudhë, çdo ofrues i FCR-së duhet të sigurojë që njësitë ofruese me rezervuarë të kufizuar të energjisë të FCR-së, janë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR në mënyrë të vazhdueshme për të paktën 15 minuta ose, në rast të devijimeve të frekuencës që janë më të vogla së një devijim i frekuencës që kërkon aktivizim të plotë të FCR-së, për një kohëzgjatje të barabartë ose për një periudhë të përcaktuar nga secila OST, e cila nuk duhet të jetë më e madhe së 30 ose më e vogël së 15 minuta.

4. Supozimi kryesor i metodologjisë

4.1 Simulimi i periudhës kohore

Metodologjia e tanishme e CBA-së do të bazohet në një model realist simulimi, i dobishëm për të kuptuar efektet aktuale të LER-së në rregullimin e frekuencave për skenarë të ndryshëm.

Një çështje kryesore që duhet të vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet modeli i duhur i simulimit për analizën e sigurimit të FCR-së lidhet me afatet kohore të fenomeneve të përfshira.

Fenomeni dinamik dhe rregulloret relevante në sjelljen e frekuencës janë si në vijim:

- Inercia e sistemit (rrotulluese dhe sintetike së bashku) kufizon gradientin e frekuencës pas një shqetësimi në sistem. Ajo ka ndikim në një shkallë shumë të shkurtër kohore (0 ÷ 15s) dhe është vendimtare në kufizimin e vlerave maksimale/minimale të frekuencës gjatë rastit para hyrjes në operim të FCR-së.
- Përgjigja dinamike e FCR-së. Secila njësi që ofron FCR shpërndan kapacitetin e vet të FCR-së, me një prirje dinamike specifike në lidhje me çështjet e saj teknike. Koha maksimale e shpërndarjes është përcaktuar në nenin 154 të SO GL.
- Përgjigja dinamike e FRR-së. I referohet shkallës kohore në të cilën janë aktivizuar si FRR automatike ashtu edhe manual (1 ÷ 15 min).

Për objektivin e propozimit të metodologjisë aktuale të CBA-së, të dy inercitë e sistemit dhe fenomenet e përgjigjes dinamike të FCR-së do të neglizhohen. Metodologjia ka në fakt qëllimin për të hetuar efektet e rezervuarit të kufizuar të energjisë të një pjesë të ofruesve të FCR-së në kuadrin e rregullimit të frekuencës.

Për qëllime të kësaj metodologjie, prania e LER-it ka efekt në sistem sapo rezervuari i energjisë të jetë i zbrazur. Sipas SO GL neni 156 (10) kjo zbrazje duhet të ndodhë jo para 15 minutash pas nxitjes së një gjendje alarmi ose, në rast të devijimeve të frekuencës që janë më të vogla së një devijim frekuence që kërkon aktivizim të plotë FCR-së, për një kohëzgjatje ekuivalente.

Kjo do të thotë së efektet e zbrazjes së LER-së ndodhin në një kohë shumë më të madhe së afatet kohore në të cilën inercia dhe përgjigja dinamike e FCR-së tregojnë efektet e tyre.

Nëse në sistem ndodh një kontigjencë, frekuenca bie me një gradient në raport me inercinë e sistemit sinkron derisa FCR-ja të jetë aktivizuar plotësisht. Frekuenca minimale e arritur gjatë rastit kalimtar varet vetëm në dinamikën e inercisë së sistemit dhe aktivizimit të FCR-së. Prania e LER-së nuk ndikon në frekuencën e sistemit në këtë kontekst, përderisa LER-ja aktivizon rezervën e tij pavarësisht nga rezervuari i tij.

Në përputhje me këto fakte, problemi i lidhur me inercinë e kufizuar të sistemit, për shkak të penetrimit në rritje të teknologjive gjeneruese të bazuara në invertor, është i pavarur nga prania e LER-së dhe nga dimensionimi i rezervuarit të tyre të energjisë.

Për më tepër, metodologjia e tanishme CBA ka për qëllim të vëzhgojë efektin e LER pavarësisht nga teknologjia e tyre specifike. LER-ja mund të jetë i bazuar në inverter (p.sh. qelizat elektrokimike) ose rrotulluese (p.sh. hidrocentralet e vegjël); ata mund të kenë në fakt efekte të ndryshme në rastin kalimtar të frekuencës për shkak të inercive të tyre të ndryshme dhe përgjigjes dinamike të FCR-së.

Analiza e cilësisë së frekuencës në terma afatshkurtër (siç influencohet nga inercia dhe përgjigja dinamike e FCR-së) shkon përtej qëllimeve të kësaj metodologjie të CBA-së, sepse ajo nuk ndikon në përzgjedhjen e periudhës kohore.

Modeli i simulimit i implementuar duhet atëherë të marrë parasysh aktivizimin e FCR-së pa përgjigjen e tij dinamike (duke e konsideruar sistemin gjithmonë në gjendje të qëndrueshme në lidhje me FCR) dhe me aktivizimin e përgjigjes dinamike të FRR-së.

5. Metodologjia

Qëllimi kryesor i propozimit të metodologjisë CBA i përshkruar në këtë paragraf është të identifikojë kombinimin e periudhës minimale kohore (T_{min} LER) të aktivizimit të plotë gjatë gjendjes së alarmit, LER Share dhe sasisë totale të FCR-së që do të prokurohet në zonën sinkrone që përfshin koston më të ulët të FCR-së në terma kohorë afatshkurtër, pa rrezikuar sigurinë e sistemit. Rritja e FCR-së ka vetëm qëllimin për të vlerësuar rreziqet e qëndrueshmërisë së sistemit dhe koston totale të FCR-së në rast të rritjes së volumit total të FCR-së siç kërkohet nga neni 156 (11d) i SO GL. Duhet theksuar së dimensionimi i FCR-së është përcaktuar në nenin 153 të SO GL, prandaj nuk mund të jetë subjekt i kësaj metodologjie CBA.

Për të arritur këtë qëllim metodologjia është e organizuar në detyrat e mëposhtme:

- Vlerësimin e procesit të mbajtjes së frekuencës (FCP) në praninë e LER-së i bazuar në simulimet dhe duke marrë parasysh një metode propabilistike për shkaqet kryesore të devijimeve të frekuencës. Aktiviteti synon të përcaktojë sasinë e kostove totale të FCR-së dhe dimensionimin e FCR-së duke pasur parasysh skenarë të ndryshëm.

- Vlerësimin e qëndrueshmërisë së sistemit energjetik që simulon praninë e LER-së gjatë ngjarjeve reale më të rëndësishme të frekuencës. Ekzistojnë sekuenca komplekse të ngjarjeve të cilat mund të çojnë në disbalanca të rëndësishme të fuqisë që nuk mund të vëzhgohen me anë të simulimeve probabilistike. Qasja e propozuar për të kapërcyer këtë kompleksitet modelimi është simulimi i skenarëve të ndryshëm të pjesëmarrjes së LER-së në FCR gjatë ngjarjeve më të rëndësishme të ndodhura në të vërtetë duke filluar nga të dhënat e regjistruara të frekuencës. Veprimtaria synon të verifikojë që kombinimet e periudhës kohore, të LER-së Share dhe dimensionimi i FCR-së nuk rrezikojnë qëndrueshmërinë e sistemit, duke çuar potencialisht në një gjendje black-out-i, edhe gjatë shqetësimeve më të rëndësishme reale të frekuencës.

Metodologjia do të bazohet vetëm në vlerësimin e riskut të qëndrueshmërisë. Kjo nënkupton që përkeqësimi i mundshëm i cilësisë së frekuencës - që lidhet me periudha të ndryshme kohore - do të neglizhohet.

Paragrafi i mëposhtëm do të përshkruajë në detaje supozimet dhe metodologjinë e CBA-së, si dhe kriteret për vlerësim që duhet të miratohen.

5.1 Vlerësimi i FCP-së në praninë e LER-së: bllok-skema e procedurës

Në këtë paragraf është paraqitur bllok-skema e procedurës (*workflow*) për vlerësimin e FCP-së në praninë e LER-së.

Bllok-skema merr si hyrje një grup variablash që identifikojnë skenarin që do të vëzhgohet. Përveç periudhës së kohës minimale $T_{min\ LER}$, shumë variabla të tjerë janë të nevojshëm për vlerësimin e FCP - të gjithë këto variabla karakterizojnë një skenar. Një përshkrim i skenarëve që do të shqyrtohen në CBA dhe supozimet kryesore të tyre është treguar në paragrafin 5.7.

Rezultati i bllok-skemës është një kosto e lidhur me skenarin. Skenarë të ndryshëm mund të analizohen më pas duke krahasuar kostot e rezultateve. Për një skenar simulimi të përgjithshëm, bllok-skema e procesit ilustrohet në figurën 1.



Figura 1. Bllok-skema e procesit

Procesi është përmbledhur në hapat e mëposhtëm:

1. Trendi historik i frekuencës ($\Delta f_{historike}$) është analizuar në mënyrë që të përcaktojë devijimin determinist të frekuencës siç përshkruhet në paragrafin 5.2.

2. Modeli propabilistik i simulimit (paragrafi 5.4) i përdorur me qellim që të llogarisë statistikat e frekuencës së simuluar (Δf_{sim}).

3. Statistikat e frekuencës së simuluar janë analizuar me qëllim që të llogarisin efektet potenciale të zbrazjes së LER në qëndrueshmërinë e sistemit.

4. Nëse analizat probabilistike nxjerrin në dukje që zbrazja e LER-së që detyron devijimin e frekuencës të arrije pragun maksimal të gjendjes së qëndrueshme, atëherë rritet dimensionimi i FCR-së (me një hap fuqie të përcaktuar) dhe vazhdohet me simulimin tjetër.

5. Hapat e mëparshëm 2, 3 dhe 4, përsëriten në një proces iterativ derisa të plotësohen kërkesat e përcaktuara në hapin 4.

Rezultati përfundimtar i këtij cikli përsëritës është vlera e fundit e dimensionimit të FCR-së (FCR_{final}). Kjo është vlera minimale e rritur e FCR-së e cila lejon të shmanget që zbrazja e LER të beje që frekuenca të arrije në pragun maksimal të gjendjes së qëndrueshme.

6. FCR_{final} është përdorur për të vlerësuar koston totale të sistemit duke përdorur kurbat e kostos së rezervës (siç përcaktohet në paragrafin 5.6.1.1).

7. Rezultati final i procesit është kosto totale e sistemit.

Siç theksohet në figurën 1, procedura mund të ndahet në katër seksione të ndryshme:

- Llogaritjet e devijimit të frekuencës deterministike nga të dhënat historike të frekuencës;
- Modeli për simulimin e frekuencës probabilistike;
- Dimensionimi i FCR-së përsëritëse;
- Vlerësimi i kostove.

Një përshkrim i detajuar i çdo seksioni është paraqitur në paragrafët në vijim.

5.2 Llogaritja e devijimit të frekuencës deterministike nga të dhënat historike

Disbalancat e fuqisë në një zonë sinkrone shkaktojnë devijimet e frekuencës që FCP-ja dhe FRP-ja duhet të mbajnë dhe rivendosin.

Disbalancat e fuqisë mund të përshkruhen si diferencë e menjëhershme midis ngarkesës dhe gjenerimit. Në disbalancimin e sistemit, mund të kenë ndikim shumë faktorë, për shembull:

- Efektet e nxitura nga tregu për shkak të diferencës së fuqisë midis linearitetit të vazhdueshëm të ngarkesës dhe gjenerimit jolinear /me shkallë në përputhje me skedulimin që rezulton nga tregu;

- Ndërprerjet në elementet e rëndësishëm të rrjetit (gjeneruesit, ngarkesat, lidhjet HVDC, etj.);
- Gabimet në parashikimin e ngarkesës;
- Gabimi i parashikimit të burimeve të rinovueshme të energjisë të paprogramueshme (NP RES) (p.sh. era dhe solari).

Disa nga këto fenomene janë përcaktuese (p.sh. efektet e nxitura të tregut)-ato mund të parashikohen me përafrim të mirë.

Disa fenome mund të vlerësohen vetëm nga pikëpamja statistikore - p.sh. teorikisht është e mundur të vlerësohet shpërndarja e probabilitetit të gabimeve të parashikimit duke parë gabimet tipike të bëra në të kaluarën.

Ka fenomene të tjera që janë vetëm statistikisht të parashikueshme (p.sh. ndërprerjet).

Një simulim i plotë i FCP dhe FRP duhet të marrë parasysh të gjitha këto efekte, megjithatë, mund të jetë e vështirë për të marrë informacion të besueshëm për të gjithë ata dhe është edhe më sfiduese për të vlerësuar evolucionin e tyre në të ardhmen.

Burimi kryesor i informacionit është sigurisht regjistrimi historik i frekuencave e çdo zone sinkrone. Këto të dhëna megjithatë janë rezultatet e kombinimit të të gjitha efekteve të ndryshme me reagimin e sistemit për shkak të FCP-së dhe FRP-së.

Përcaktimi i komponentëve të ndryshëm të disbalancave të fuqisë nga të dhënat e frekuencës mund të jetë me të vërtetë një proces shumë kompleks.

Disbalanca e energjisë që do të menaxhohet nga FCP-ja dhe FRP-ja në vlerësim do të llogaritet duke marrë parasysh vetëm efektet më të rëndësishme mbi frekuencën, të cilat janë ndërprerjet dhe efektet e nxitura nga tregu. Faktorë të tjerë që ndikojnë në disbalancimin e fuqisë në lidhje me gabimet e parashikimit të ngarkesës dhe NP-RES konsiderohen në mënyrë implicite në devijimin e qëndrueshëm të frekuencës (paragrafi 5.3) të cilat bazohen në analizën statistikore të të dhënave historike të frekuencës.

Ndërprerjet do të modelohen me metodën probabilistike të Montekarlos (paragrafi 5.4) – disbalancat e nxitura nga tregu do të llogariten duke filluar nga të dhënat historike të frekuencës.

Disbalancat e nxitura nga tregu janë disbalanca gjenerim-ngarkesë të shkaktuara nga ndryshimi në tarimet e gjenerimit në përputhje me rezultatet e të planifikimit të tregut. Këto janë një nga fenomenet më të rëndësishme të disbalancimit pasi ato mund të shkaktojnë një tejkalim të diapazonit të frekuencës standarde për disa herë çdo ditë.

Karakteristika kryesore e këtyre devijimeve është së ato ndodhin në periudha të caktuara gjatë ditës, me modele specifike prirje. Ata zakonisht ndodhin gjatë ndryshimit të orës.

Falë kësaj parashikueshmërie, fenomenet quhen devijime deterministe të frekuencës.

Devijimet deterministe të frekuencës do të analizohen duke filluar nga të dhënat historike të frekuencës të regjistruara nga OST-të gjatë 15 viteve të fundit, përfshirë 2017.

Një trend historik përcaktues i devijimit të frekuencës llogaritet duke filluar nga të dhënat e frekuencës të secilës zonë sinkron. Siç përshkruhet në figurën 2, devijimi deterministik i frekuencës i marrë në vlerësimin e FCP-së do të merret duke analizuar devijimin historik të frekuencës dhe duke marrë parasysh rregullat e faturimit së tregut.



Figura 2. Shembull i një trendi ditor të të dhënave historike të frekuencës dhe devijimit deterministik të frekuencës

Trendi i devijimit të frekuencës deterministike analizohet më tej në mënyrë që të identifikojë mbivendosjen e mundshme me fenomenet e tjerë. Në veçanti do të identifikohen dhe eliminohen mbivendosjet me ndërprerjet e regjistruara specifike në zonën sinkrone.

Meqë ndërprerjet merren parasysh veçmas nëpërmjet qasjes së Montekarlos, ngjarjet faktike të identifikuara duhet të neglizhohen.

Devijimi determinist i frekuencës ($\Delta f_{\text{deterministike}}$) paraqet një nga të dhënat hyrëse të modelit probabilistik të simulimit.

5.3 Devijimet e qëndrueshme të frekuencës

Gjatë operimit të secilës zonë sinkrone, mund të ndodhin disa ngjarje në të cilat devijimi i frekuencës nuk mund të rikthehet në 50 Hz nga FRP (madje pa shkaktuar një gjendje alarmi).

Gjatë këtyre ngjarjeve (devijime të qëndrueshme të frekuencës), frekuenca mbetet rreth diapazonit të frekuencës standarde gjatë një periudhe të zgjatur pa nxitur gjendjen e alarmit.

Devijimet e qëndrueshme të frekuencës zakonisht lidhen me shterimin e FRR në një zonë të vetme LFC. Mund të ndodhë që, për shkak të kontigjencave në një zonë të vetme të LFC-së, aktivizohet sasia totale e FRR-së së disponueshme e kësaj zone - ky aktivizim mundet të mos jetë i mjaftueshëm për të rivendosur devijimin e frekuencës në zero, sepse FRR-ja e dimensionuar është më e vogël së disbalanca e fuqisë shkaktuar nga kontigjencat. Në këto kushte, një pjesë e disbalancës së fuqisë është e balancuar vazhdimisht nga FCR-ja e të gjithë zonës sinkrone që potencialisht shkakton një devijim të qëndrueshëm të frekuencës. FRR e zonave të tjera të LFC-së që nuk janë prekur nga kontigjencat nuk janë në gjendje të rivendosin devijimin e frekuencës në zero, sepse nuk aktivizohet vetëm në bazë të frekuencës.

Duke konsideruar shterimin e FRR-së me anë të devijimit të qëndrueshëm të frekuencës, lejon shmangien e marrjes në konsideratë të ngopjes së FRR në modelin e simulimit të diagramit të bllokut.

Kjo natyrë ngjarjesh do të merret parasysh, pasi ato mund të mbivendosen me burime të tjera të devijimit të frekuencës siç janë ndërprerjet e simuluara në procesin e Montekarlos.

Meqenëse devijimet e qëndrueshme të frekuencës janë ngjarje të paparashikuara, mënyra më e mirë për t'u marrë parasysh është nëpërmjet një metode probabilistike.

Duke analizuar tendencat historike të frekuencës të regjistruara nga OST-të gjatë 15 viteve të fundit, përfshirë vitin 2017, është e mundur që dukuria të përshkruhet nga pikëpamja statistikore.

Analiza do të konsiderojë si devijim të qëndrueshëm të frekuencës të gjitha ngjarjet me një devijim mesatar të frekuencës në gjendje të qëndrueshme të sistemit, më të madhe së sa devijimi standard i frekuencës gjatë një periudhe më të gjatë së koha për të rivendosur frekuencën.

Duke marrë parasysh trendin disavjeçar të frekuencës për secilën zonë sinkrone, analiza do të përcaktojë:

- Numrin e ndodhjes së këtyre ngjarjeve;
- Kohëzgjatjen tipike;
- Trendin përfaqësues të devijimit të frekuencës;
- Kohën tipike të ndodhjes, nëse nxirret në pah nga analiza statistikore.

Këto informacione statistikore sintetike do të përdoren si të dhëna hyrëse për modelin probabilistik të simulimit Montekarlos.

Modeli Montekarlos më pas simulon devijimet e qëndrueshme të frekuencës rastësore gjatë vitit dhe në përputhje me informacionin statistikor të lartpërmendur.

5.4 Modeli për simulimin probabilistik të frekuencës

Modeli i simulimit të frekuencës është mjeti kryesor për të analizuar efektet e LER-së mbi frekuencën krahasuar me kushtet aktuale të operimit për kontrollin ngarkesë-kontroll të frekuencës dhe rezervat.

Modeli i simulimit mund të përfaqësohet si një model input-output siç tregohet në figurën 3.



Figura 3

Qëllimi i modelit është të simulojë procesin e kontrollit ngarkesë - frekuencë duke adoptuar një metodë probabilistike. Modeli duhet të jetë në gjendje të simulojë si FCP edhe FRP për çdo zonë sinkrone dhe si pasojë të llogarisë një frekuencë probabilistike ($\Delta f_{probabilistike}$) për skenarë të ndryshëm.

Siç është trajtuar në 4.1, simulimet neglizhojnë inercinë e sistemit dhe përgjigjen dinamike të FCR-së, ndërkohë që merren parasysh efektet e FCR-së në gjendje të qëndrueshme dhe të FRR-së (me dinamikën e saj). Informacioni hyrës i dhënë që konsiderohet për llogaritjen e frekuencës probabilistike do të jetë:

- FCR: shuma totale e rezervës së mbajtjes së frekuencës në të gjithë zonën sinkrone. FCR-ja do të reduktohet kur një sasi e LER-së ndodh të shterojë, pasi FCR-ja e tyre nuk është më në dispozicion;
- Koha e aktivizimit të plotë të FRR-së;
- Një listë e ndërprerjeve të elementeve të rëndësishëm të rrjetit që sjell një ndryshim në disbalancimin e fuqisë. Probabiliteti i ndodhjes së ndërprerjeve sipas tipit të ngjarjes dhe teknologjisë së gjenerimit do të merret me anë të statistikave për të dhënat historike duke marrë parasysh së paku:
- të dhënat e platformës së transparencës të ENTSO-E;
- informacioni i mbledhur në raportin e LFC-së lidhur me disbalancat më të rëndësishme të fuqisë (disbalancat e fuqisë më të mëdha së 1000 mw);
- studime kërkimore të bazuara në statistikat e difektit të njësisë;
- Devijimet deterministike të frekuencës siç përshkruhet në 5.2;
- Informacion statistikor në lidhje me devijimet e qëndrueshme të frekuencës të përcaktuara në përputhje me paragrafin 5.3.

5.4.1 Metoda e Montekarlos

Metoda probabilistike ka për qëllim të llogarisë disa kushte operacionale për procesin e kontrollit ngarkesë-frekuencë, duke marrë parasysh devijimet deterministe të frekuencës, devijimin e qëndrueshëm të frekuencës dhe efektet e ndërprerjeve.

Kjo lloj metode mund të zbatohet duke përdorur algoritme të Montekarlos, në të cilat simulohen një numër i madh i viteve: kontigjenca do të ndodhë në varësi të probabilitetit të tyre.

Një rend i proceseve i paraqitur skematikisht për algoritmin është paraqitur në figurën 4.



Figura 4. Rendi i proceseve i paraqitur skematikisht i Montekarlos

Zona me ngjyrë përfaqëson procesin që do të përsëritet N herë në mënyrë që të simulojë gjendjen më të gjerë operacionale të sistemit, të mundshme. Parametri N duhet të jetë mjaftueshëm i madh për të arritur rezultate statistikisht të rëndësishme.

Çdo simulim paraqet një gjendje të mundshme të sistemit gjatë vitit.

Disbalanca e fuqisë për shkak të ndërprerjeve llogaritet duke filluar nga një listë e kontingjencave të mundshme me probabilitetin e tyre të ndodhjes. Duhet të ketë një bllok në gjendje për të gjeneruar rastësisht ndërprerjet duke marrë parasysh shkallën aktuale të difektit të secilit element në listën e marrë parasysh.

Blloku, gjithashtu, duhet të jetë në gjendje të nxjerrë në mënyrë rastësore ngjarjet e devijimit të frekuencës së qëndrueshme, duke filluar nga shpeshtësia tipike e tyre e ndodhjes.

Ngjarjet e kontigjencave (kombinimi i ndërprerjeve dhe ngjarjet e devijimit të qëndrueshëm të frekuencës) do të konsiderohen si të pavarura dhe të përafruara nga njëri-tjetri. Kjo është një përafrim i operimit të sistemit në kohe reale, dhe praktikisht një korrelacion midis ndërprerjeve dhe devijimit të rëndësishëm të frekuencës të shkaktuar nga faktorë të tjerë që mund të ngjasin, p.sh. një ndërprerje e paplanifikuar e njësisë gjeneruese mund të shkaktohet nga aktivizimi i mbrojtjes së tij nga frekuencën, duke rritur kështu disbalancën e energjisë edhe gjatë kushteve kritike.

Kontigjencat dhe devijimi deterministik i frekuencës janë të dhëna hyrëse për modelin dinamik deterministik (5.4.2) që simulon një proces të thjeshtuar të procesit të rregullimit frekuencës-ngarkesë duke llogaritur devijimin e frekuencës. Çdo simulim gjeneron si rezultat një trend të devijimit të frekuencës.

Një bllok tjetër integron informacionin nga të gjitha vitet e simuluara. Vendimi nëse rritet ose nuk rritet FCR-ja, në mënyrë që të kompensohet një zbrazje e LER-së që nuk mund të tejkalohet nga ofruesit e mbetur të FCR-së do të bëhet duke marrë parasysh të gjitha vitet e simuluara në mënyrë që të jetë më përfaqësuesi i mundshëm i të gjitha kushteve të mundshme operacionale që FCP dhe FRP duhet të përballojë.

5.4.2 Bllok diagrami i modelit të simulimit

Një diagram logjik për modelin e simulimit është paraqitur në figurën 5 më poshtë.



Figura 5

Modeli i referohet një sistemi të tërë sinkron. Çdo bllok përshkruhet në paragrafët e mëposhtëm.

Kontrolluesi i restaurimit të frekuencës sinkrone

FRP-ja ka për qëllim të kontrollojë gabimin e kontrollit të restaurimit të frekuencës në drejtim të zeros. Kur një zonë sinkrone përmban më shumë së një zonë LFC, gabimi i kontrollit të restaurimit të frekuencës - ose gabimi i kontrollit të zonës (ACE) - llogaritet nga devijimi ndërmjet shkëmbimit të planifikuar dhe aktual të një zone LFC (përfshirë Virtual Tie-Lines nëse ka) e korrigjuar nga faktori i frekuencës (K-faktori i zonës LFC shumëzuar me devijimin e frekuencës. Meqenëse modeli i implementuar simulon sistemin zonës sinkrone në tërësi, gjithë procesi i rregullimit ngarkesë-frekuencë ndërkufitar atëherë mund të neglizhohet.

Modelet e kontrolluesit të restaurimit të frekuencës sinkrone, simulon në fakt vetëm veprimin proporcional-integral të FRP-së mbi gabimin e frekuencës (Δf_{sim}).

I gjithë procesi i restaurimit të frekuencës i zonës sinkrone është modeluar me një rregullator të vetëm me një kohë të aktivizimit të plotë (FAT ose Full Activation Time) të llogaritur si mesatare e FAT-së e të gjitha zonave LFC që i përkasin zonës sinkrone konsideruar kontributin e K-faktorit në FRR.

Kontrolluesi i Restaurimit të Frekuencës Sinkrone nuk modelon ngopjen e FRR-së. Burimi konsiderohet pa kufizime pasi që fenomeni në lidhje me FRR-e shteruar janë marrë në konsideratë mënyrë implicite duke marrë parasysh ngjarjet e devijimit të qëndrueshëm të frekuencës.

FRP-ja e simuluar operon vetëm në shqetësime të shkaktuara nga ndërprerje si për devijimet standarde të frekuencës edhe për devijimet e qëndrueshme të frekuencës tashmë të përfshira në mënyrë implicite në aktivizimin e FRR-së. Modeli duhet të zhvillohet në mënyrë që dallojë dy llojet e ndryshme të shqetësimeve dhe të aktivizojë FRR-në vetëm në lidhje me ndërprerjet.

Ngopja e FCR-së

Modelet bllok të ngopjes tregojnë disponueshmërinë e kufizuar të FCR-së së zonës sinkrone.

Vlerat e ngopjes së FCR-së varen në kriterin e dimensionimit të përshtatur në çdo zonë sinkrone.

Me këtë bllok është e mundur të modelohet sjellja e LER-së për një kohe minimale të përcaktuar në të cilën ato duhet të sigurojnë FCR.

Ky bllok është në këtë mënyrë i varur nga frekuenca: nëse pjesë e FCR-së është siguruar nga LER-ja, vlerat e ngopjes duhet të reduktohen sapo të kenë shteruar rezervuarin e energjisë.

Pjerrësia e sistemit (droop)

Blloku i pjerrësisë (droop) paraqet kurbën totale mw/Hz të të gjithë zonës sinkrone në tërësi.

Kurba është shumatorja e kurbave të ndryshme mw/Hz të zonave LFC, të cilat janë pjesë e zonës sinkrone. Gjithashtu, ky bllok është varur nga frekuenca: nëse pjesë e siguruesve të FCR-së është dhënë nga LER-ja, pjerrësia ndryshon sapo ata të kenë shteruar rezervuarin e energjisë.

Sjellja e frekuencës së sistemit

Modelet bllok tregojnë lidhjen midis disbalancës së fuqisë dhe devijimit të frekuencës.

5.4.3 Simulimi i zbrazjes së energjisë nga LER-ja

Në SO GL neni 156 (9) është specifikuar se LER-ja duhet të jetë vazhdimisht në dispozicion gjatë gjendjes

normale.

LER-ja konsiderohen pa kufizime energjie, ndërsa frekuenca mbetet brenda intervalit të frekuencave standarde.

Nëse një tejkalim i vazhdueshëm i vargut të frekuencave standarde përfshin nxitjen e një gjendje alarmi, energjia e aktivizuar dhe energjia e mbetur në rezervuar llogaritet nga tejkalimi i parë i limiteve të frekuencës standarde.

Energjia e mbetur merret parasysh edhe nëse gjendja alarmuese nuk është shkaktuar ende; kjo zgjedhje e implementimit është për shkak të faktit se gjendja e alarmit shkaktohet pas kohës nxitëse të gjendjes të alarmit.

Duke marrë parasysh një situatë të përgjithshme në të cilën shkaktohet gjendja e alarmit, shkaku aktual i gjendjes së alarmit ndodh pas një periudhe me devijim të frekuencës përtej devijimit standard të frekuencës. Për shembull, në zonën sinkronike nordike, gjendja e alarmit mund të ndodhë për shkak të devijimit të frekuencës vazhdimisht mbi 250 mHz për të paktën 5 minuta.

Duke marrë parasysh pragjet e sistemit nordik si një shembull, edhe nëse periudha midis kapërcimit të ± 100mHz dhe shkaktarit të gjendjes së alarmit mund të konsiderohet si gjendje normale, është shumë e vështirë që LER të mund ta mbajë plotësisht rezervuarin e saj të energjisë në këtë situatë.

Konsumi aktual i energjisë gjatë këtij tranzicioni nga gjendja normale në gjendjen e alarmit duhet të merret parasysh. Figura 6 jep një shembull lidhur me zonën sinkronike nordike.



Figura 6. Pragjet fillestare për analizën e konsumit LER (shembull i referuar zonës sinkronike nordike)

Duhet të theksohet se marrja parasysh konsumin e energjisë para shkaktarit aktual të gjendjes alarmuese nuk nënkupton asnjë mbi dimensionimin të rezervuarit LER sipas SO GL neni 156. Energjia e siguruar nga LER-ja para momentit në të cilin është shkaktuar gjendja alarmuese llogaritet në llogaritjen e energjisë së kërkuar.

Në fakt, periudha kohore e përdorur në simulimet reflektohet në një përmbajtje të energjisë të kërkuar për rezervuarin LER. Kjo përmbajtje e energjisë është e barabartë me aktivizimin e plotë të FCR-së për periudhën kohore (p.sh. një periudhë kohore e barabartë me 15 minuta në sistemin nordik reflektohet në një përmbajtje të energjisë të barabartë me sigurimin e FCR-së për shkak të devijimit 500 mHz që zgjat për 15 minuta). Energjia e konsumuar përpara nxitësit të gjendjes së alarmit është përfshirë në këtë përmbajtje të energjisë.

Figura 7 e mëposhtme jep një shembull se si konsulimi i energjisë simulohet në këtë metodologji. Në këtë shembull, nëse simulohet një periudhë kohore prej 15 minuta, energjia ekuivalente e kërkuar (e barabartë me aktivizimin e plotë të FCR-së për 15 minuta) fillon të përdoret sapo devijimi i frekuencës të tejkalojë intervalin e frekuencës standarde. Kjo nënkupton që zbrazja e plotë mund të ndodhë para se të kalojnë 15 minuta të gjendjes së alarmit.



Figura 7. Shembull i zbrazjes për një rezervuar ekuivalent 15 minutësh në sistemin nordik

Në disponueshmërinë e plotë të rezervuarit, vlera fillestare e nivelit të energjisë do të jetë e barabartë me gjysmën e kapacitetit të energjisë kuivalente të rezervuarit. Kapaciteti ekuivalent i energjisë (E_{max}) llogaritet për çdo periudhë kohore ($T_{\min LER}$) me formulën e mëposhtme:

$$E_{max} = 2 * \frac{T_{\min LER}}{60} * FCR_{LER} \ [MWh]$$

Ku FCR_{LER} është FCR e siguruar nga LER [mw].

Në shterimin e rezervuarit të energjisë, LER-ja ndalet për të siguruar FCR - kjo do të thotë se të dyja kurbat mw/Hz dhe shuma totale e FCR-së në sistemin janë modifikuar.

5.5 Dimensionimi përsëritës i FCR-së

Qëllimi i CBA aktual është të vlerësojë kostot e sistemit të lidhura me periudhën minimale të ndryshme në të cilën LER duhet të ofrojë FCR duke marrë parasysh ndikimin e tyre në rrezikun e stabilitetit. Modeli i simulimit i përdorur për llogaritjen e gabimit probabilistik të frekuencës në prezencën e LER-së midis ofruesve të FCR-së pritet të vlerësojë një përkeqësim potencial të frekuencës në krahasim me një gjendje në të cilën të gjithë ofruesit e FCR-së janë pa kufizime energjie.

Pritet që sa më shumë të zvogëlohet $T_{\min LER}$ aq më shumë që është e mundur që LER-ja të mund të zbrazet si pasojë e një kombinimi të veçantë të ndërprerjeve dhe devijimeve përcaktuese të frekuencës.

Për arsyeve sigurie, supozohet se një zbrazje LER mund të jetë e pranueshme vetëm nëse nuk sjell kurrë një ngopje të FCR-së. Me fjalë të tjera, një zbrazje LER kurrë nuk do të përfshijë frekuencën e qëndrueshme të shtetit për të kapërcyer devijimin maksimal të gjendjes së qëndrueshme të frekuencës.

Nëse ndodh një zbrazje LER, FCR-ja e aktivizuar nga LER-ja do të zhduket. Ky FCR i aktivizuar duhet të zëvendësohet nga ofruesit e mbetur jo-LER. Ofruesit e mbetur jo-LER duhet të kenë një FCR të mjaftueshëm të pa aktivizuar për të zëvendësuar LER të varfëruar të aktivizuar FCR-në.

Dy shembuj të përgjithshëm që lidhen me zonën sinkrone të Evropës Kontinentale tregohen në figurën 8 dhe figurën 9 më poshtë.



Figura 8. Situata e pranueshme - LER i zbrazur mund të zëvendësohet me jo-LER

Në figurën 8 është treguar një situatë ku zbrazja LER është e pranueshme pasi nuk rrezikon stabilitetin e sistemit. Ka 1000 mw LER FCR dhe 2000 mw jo-LER FCR.

Aktivizimi i plotë i FCR-së ndodh për shkak të një çekuilibri të energjisë. Devijimi i frekuencës arrin një vlerë të qëndrueshme të barabartë me devijimin maksimal të frekuencës së qëndrueshme të gjendjes (200 mHz në Evropën Kontientale).

FRR-ja fillon të rivendosë frekuencën.

